

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. D6978 / prot.

Tiranë, më 10/05/2024

Lënda: **Kthim përgjigje**

Z. DORIAN MATLIJA

Qendra "Res Publica"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" janë paraqitur kërkesat tuaja, të cilat janë protokolluar përkatësisht me nr. prot. D-6849, datë 25.04.2024 dhe nr. prot. D-6979, datë 26.04.2024 dhe kanë kaluar për shqyrtim pranë strukturave përkatëse, të cilat kanë kthyer përgjigje si vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile me shkresën me nr. prot. D-6979/1 dhe nr. prot. D-6849/1, datë 08.05.2024 si vijon:

"Referuar kërkesave për informacion mbi përcjelljen e informacionit lidhur me pallatin nr. 5, rruga "Ferit Xhajko", ju bëjmë me dije se, Drejtoria e Emergjencave Civile, bazuar në ligjin nr. 119, datë 18.09.2014 dhe dispozitave të tjera në fuqi po ju vëmë në dispozicion kopje të dokumentacionit që disponojmë si më poshtë:

- VKB-në nr. 24, datë 26.02.2024 për objektin e sipërcituar të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.
- Oponencën teknike të kryer nga ekspertë e Institutit të Ndërtimit për këtë objekt.
- Kopje të njërit prej njoftimeve të bëra banorëve (si model) dhe kemi vënë në dijeni Njësinë Administrative nr. 8.

Lidhur parashikimin e afatit të demolimit nuk mund të japim një datë të saktë pasi jemi në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për kryerjen e procedurës së prokurimit nga ku do të përzgjidhet subjekti dhe do të lidhet kontrata me afatin e përcaktuar për kryerjen e procedurës".

"Ndërkohë Këshilli Bashkiak me shkresën me nr. prot. D-6849/2, datë 08.05.2024 informon se në vijim të kërkesës suaj bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 24, datë 26 Shkurt 2024, shoqëruar me oponencën teknike në formatin hard copy me firmë".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE NË
BASHKËPRONËSIADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

13264/37
Nr. ____ prot.

Tiranë më, 28,03 2024

Lënda: Njoftim.

Z.

Adresa: Pallati Nr. 5, rruga "Ferit Xhajko", Njësia Administrative Nr. 8,

Për dijeni: NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 8

Në kuadër të marrjes së masave për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë", për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 Bashkia e Tiranës ka ndjekur procedurat për kryerjen e Aktekspertizës së Thelluar në objektet e dëmtuara, mbështetur në VKM Nr. 26 datë 15.01.2020 "Për kryerjen e Aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Ashtu siç ju kemi njoftuar, me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 24, Datë 26.02.2024, është vendosur demolimi i detyruar i pallatit Nr. 5, rruga "Ferit Xhajko", Njësia Administrative Nr. 8, bazuar në verifikimet dhe akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit, grupeve të punës së njësive administrative për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe rrezikun që paraqitej, është kryer aktekspertiza e thelluar me operator ekonomik.

Mbështetur në përfundimet e aktekspertizës së thelluar si dhe në opionencën teknike të Institutit të Ndërtimit, ekspertët kanë dalë në konkluzionin se pallati duhet të demolohet.

Në kuadër të procesit të ridërtimit dhe në vijim të procedurës për zbatimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak, ju njoftojmë se do të vijohet me procesin për demolimin e objektit.

Lutemi nga ana juaj të merrni masat për lirim të apartamenteve me qëllim që të përgatitet sheshi për kryerjen e punimeve për demolimin e objektit.

Ju falenderoj për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Kostandin Budurusi